
RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Fabrike e perpunimit te peshkut dhe produkteve te detit

Prill 2017



Permbajtja

1.	Kuadri ligjor dhe institucional kombetar	5
1.1	Qellimi i aktivitetit.....	5
1.2	Objektivat e aktivitetit	5
1.3	Kuadri Ligjor	6
1.4	Informacion mbi vendndodhjen e aktivitetit.....	7
1.5	Subjekti kerkues.....	8
1.6	Pershkrimi i proceseve teknologjike te perpunimit te peshkut Acuge dhe produkteve te detit.....	8
1.7	Mbetjet e prodhuara nga aktiviteti perpunues.....	11
1.8	Fuqia punetore	12
1.9	Energji, uji, karburant, gaz.....	12
1.10	Skema e tokezimeve dhe e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.	12
1.11	Masat kunder zjarrit	12
2	PERSHKRIMI I MJEDISIT	13
2.1	Popullesia.....	13
2.1.1	Perdorimi i tokes	13
2.1.2	Punesimi dhe niveli i jeteses	13
2.2	Mjedisi biologjik dhe fizik.....	14
2.2.1	Flora dhe Fauna.....	14
2.2.2	Flora	14
2.2.3	Fauna.....	15
2.3	Gjeologjia	19
2.3.1	Stratigrafia.....	19
2.3.2	Formacioni molasik.....	20
2.4	Depozitimet kuarternare.....	20
2.4.1	Tektonika.....	20
2.4.2	Neotektonika	21
2.5	Sizmiologji.....	21
2.5.1	Tektonika rajonale dhe Sizmiciteti	21
2.5.2	Sizmiciteti ne zonen e studimit	22
2.5.3	Tokat.....	22
2.5.4	Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyre.....	24
2.6	Rreshjet.....	25
2.7	Temperatura e ajrit	25
2.8	Diellezimi	26
2.9	Era.....	27
2.10	Rrjeti hidrografik i zones ne studim.....	28
2.11	Cilesia e mjedisit.....	29

2.11.1	Cilesia e ujerave sipërfaqesore dhe nentokesore	29
2.11.2	Cilesia e ajerit ne zone	29
2.11.3	Niveli i zhurmave te zones	31
2.11.4	Menaxhimi i Mbetjeve Urbane	32
3	IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS	33
3.1	Metodologjia.....	33
3.2	Vleresimi i ndikimit ne mjedis ne fazen e rikonstruksionit	34
3.3	Vleresimi i ndikimit ne mjedis ne fazen e funksionimit	36
3.4	Mbetjet e ngurta.....	38
3.5	Shkarkimet e lengeta.....	38
4	MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS	40
4.1	Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore	40
4.2	Masat zbutese per mbrojtjen e mjedisit	41
4.3	Menaxhimi i mbetjeve te ngurta	43
4.4	Menaxhimi i mbetjeve te lengeta.....	43
4.5	Menaxhimi i aromave	44
4.6	Trajnimi dhe Ndergjegjesimi	44
4.7	Programi i monitorimit dhe elementet e tij	45

HYRJE

Aktiviteti ne vleresim do te konsistoje ne proceset e perpunimit, pastrimit, konservimit dhe paketimit te peshkut per prodhimin e konservave nga lendet e para te prodhimeve. Aktiviteti ne vleresim kryesisht do te punoje si “Fason”, ose me emertimin “Perpunim aktiv”, duke nenkuptuar blerjen e produktit nga vende te tjera, perpunimin sipas kerkesave specifike dhe shitjen e tij perseri per llogari te porositesit. Per realizuar Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis investitori ka nenkontraktuar studion mjedisore Qendra e Monitorimit te Mjedisit.

1. Kuadri ligjor dhe institucional kombetar

1.1 Qellimi i aktivitetit

Projekti ne vleresim do te jete nje aktivitet i industrise ushqimore ku sipas kerkesave punohet per perpunimin e produkteve te peshkut dhe per llogari te kompanive te huaja dhe atyre shqiptare. Qellimi i ketij aktiviteti do te jete funksionimi pa krijuar probleme me mjedisin dhe komunitetin ose minimizimin e tyre. Aktiviteti ne studimi do te merret me :

- Perpunimin e llojeve te ndryshme peshqeve

Procesi teknologjik konsiston ne perpunimin e peshkut, i cili realizohet ne nje objekt te modifikuar posacerisht per kete qellim dhe fuqia punetore eshte rreth 100 punonjes.

Kapaciteti perpunues i peshkut 1 ton / dite,

SHTOJCA II. Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis

7. Industria Ushqimore

ë) Fabrika per prodhimin e ushqimeve me baze peshku dhe vajrave te peshkut

1.2 Objektivat e aktivitetit

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Shkarkimet ne ujera nga procesi teknologjik
- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga procesi teknologjik
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne pejsazhin e zones

Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte do te jete gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

1.3 Kuadri Ligjor

Gjate dhjetevjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore të cilat kanë ardhur si rezultat i industrisë para viteve 90-te dhe zhvillimeve të fundit në fushën e ndërtimit dhe industrisë.

Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) shkruhet se:

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismes dhe të përgjegjësive private, synon:

Neni d): një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Sipas Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Mjedisit është autoriteti përgjegjës për rishikimin e dokumentit VNM të përgatitur nga ekspertet e licensuar prej ministrisë së mjedisit.

Përveç Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratori edhe Ligjin Nr. 10440 Date 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”. Ky ligj është zhvilluar dhe bazuar në Direktivat e EU dhe praktikën ndërkombëtare të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Ndër ligjet e tjera të legjislacionit kombëtar në lidhje me VNM-ne dhe mjedisin përfshijnë

1. Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 ‘Për mbrojtjen e mjedisit’, të ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 ‘Për vlerësimin e ndikimit në mjedis’, të ndryshuar;
Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 ‘Për zonat e mbrojtura’ ndryshuar me ligjin, Nr.9868, datë 4.2.2008 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906 datë 6.6.2002 ‘Për zonat e mbrojtura’
3. Ligji nr. 68/2014 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, ‘Për mbrojtjen e biodiversitetit’, të ndryshuar.
4. Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis"
5. VKM nr. 686, datë 29.07.2015 ‘Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis(VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore’;
6. VKM nr. 247, datë 30.04.2014 ‘Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore’
7. Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
8. VKM nr. 575 date 24.06.2015 ‘Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte’
9. VKM nr.175, datë 19.1.2011 ‘Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve’
10. VKM nr. 371, datë 11.06.2014 ‘Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme’
11. VKM nr. 418, datë 25.06.2014 ‘Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim’
12. VKM nr. 229, datë 23. 04. 2014 ‘Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme’
13. VKM nr.519, datë 30.6.2010 ‘Parqet Natyror Rajonal’

14. VKM nr.897. datë 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave për Shpalljen e Zonave të Vecanta të Ruajtjes”
15. VKM nr. 221, datë 20.2.2013 “Caktimi i Zonave si Brezi i Gjelber i Tiranës”
16. VKM nr. 532, datë 05.10.2000 “Për miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i veprimit për biodiversitetin”
17. VKM nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”
18. VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit"
19. Vendimi Nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
20. VKM nr 352, datë 29.04.2015. “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.
21. VKM nr 177 date 31.3.2005 ‘Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese’
22. Udhezim nr.8 date 27.11.2007 per ‘Nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara.’

1.4 Informacion mbi vendndodhjen e aktivitetit

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti i kompanise “Mare Adriatik” sh.p.k eshte ne Babrru, Kamez, Tirane, ne zonen kadastrale 1066, Nr.Pasurise 430/16 .



Figure 1.Vendodhja e objektit ne lidhje me rajonin dhe zonen industrial

Koordinatat ne Gauss-Kruger te subjektit Mare Adriatik sh.p.k paraqiten ne tabelen e meposhtme.

Pikat	X	Y
1	4402425.88	4581072.45
2	4402378.51	458189.19
3	4402432.63	4581040.15
4	4402387.57	4581028.23

Subjekti kufizohet me pronat: Veri: 430/1
Jug: --
Lindje: 430/1
Perendim: 4301,

1.5 Subjekti kerkues

Subjekti “Mare Adriatik” sh.p.k, eshte nje subjekt privat i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR) me Numer Identifikimi (NIPT): K36924001T me perfaqesues ligjor Z.Mark Babani

1.6 Pershkrimi i proceseve teknologjike te perpunimit te peshkut Acuge dhe produkteve te detit

Procesi teknologjik konsiston ne perpunimin e peshkut dhe produkteve te tij, i cili realizohet ne nje objekt te rikonstruktuar pikerisht per kete qellim.

Lenda e pare , merret nga importi sipas e cila vjen me certificate veterinare ku jane te specifikuara karakteristikat e produktit, origjina, data e hyrjes dhe te daljes se produktit.

Lenda e pare mund te vije ne dy forma e fresket dhe e ngrire. Ne rastin kur jane te fresketa fillon menjehere puna per pastrimin e tyre, ndersa ne rastin kur eshte e ngrire fillohet me shkrirjen e tyre.

- Repart i perpunimit te peshkut
- Siperfaqe magazinuese te produktit te kriposur
- Dhoma frigoriferike
- Sektori i larjes se peshkut
- Dhomat e zhveshjes se punetoreve, banjot
- Zyrat

Peshku si lende e pare eshte i kriposur qe ne destinacion. Pas shkarkimit dhe vendosjes ne vendin e caktuar, realizohet larja e tij me qellim heqjen e luspave dhe kripes.

Ky material lende e pare (peshku) kalon ne kater vaska, ku luspate dhe kripa ndahen ne dy vaskat e para me kapacitet 400 l dhe 300 l. Ndersa dy vaskat e tjera jane me kapacitet 250 l secila. Procesi

i perpunimit te peshkut ka nje teknologji te thjeshte ku pasi eshte pastruar, kalon ne procesin e ndarjes, seleksionimit, perpunimit dhe ambalazhimit.

Ambalazhimi realizohet nepermjet eneve te posacme dhe te mbyllura me ambalazhe cilesore duke u bere gati per destinacionin e caktuar.

Pjesa e ngurte qe krijohet pas larjes dhe qe perfshin luspat dhe kripen, kalojne ne forme dekantimi ne mbetje te ngurta. Ujerat e vaskave nderrohen 2 here ne dite.

Me poshte po japim nje pershkrim me te hollesishem te reparteve.

Reparti i perpunimit te acuges

Ky eshte reparti kryesor ku do te jene te angazhuar pjesa me e madhe e punetoreve. Ne kete repart do te vendosen tavolinat e punes dhe karriget per punetoret. Gjithashtu ne kete salle do te instalohet nje sistem ndricimi dhe aspirimi, i cili krijon kushte normale pune dhe po ashtu do te instalohen pajisjet insekt-vrasese. Ne ane te salles do te ngrihet sektori ku jane te vendosur bidonat plastike me lenden e pare te ardhur nga importi, peshk i kriposur. Ne kete repart do te vendoset edhe impianti i larjes e pastrimit te peshkut.

Ky impiant do te perbehet nga nje sistem sitash e e konvejeresh, ku nepermjet levizjeve mekanike dhe kalimit te peshkut ne dush, kryhet larja. Makineria eshte e perbere nga nje material inoksidabel.

Centrifuga

Eshte prodhim italian dhe sherben per largimin e lageshtires nga masa e lare e peshkut qe pergatitet per filetim. Dyshemeja e repartit do te jete e patinuar dhe lyer me boje qe do te siguroje kushte higjenike optimale per prodhimin e produkteve ushqimore. Ne dysheme kalojne edhe tubacionet e per grumbullimin dhe largimin e ujerave te perdorur nga larja dhe pastrimi i peshkut. Keto ujera perfundojne ne vasken e dekantimit.

Ne repart do te vendosen edhe dhomat frigoriferike te cilat sipas rastit sherbejne per ruajtjen e lendes se pare ose produktit te gatshem. Keto dhoma jane te lidhura dhe komunikojne me repartin ne menyre qe t'i sherbejne procesit teknologjik te prodhimit.

Ne repart do te instalohen edhe cezma uji me lavamane me lares e dezinfektante. Punetoret jane te detyruar te zbatojne rregullat higjienosanitare ne pune. Ne kete objekt do te ndertohen edhe vendet e veshjes, larjes dhe duset per punetoret, te cilat jane kusht i domosdoshem per funksionimin normal te punes dhe nevojat e punetoreve.

Teknologjia e perpunimit te aciuges

Peshku acuge eshte shume i shijshem, konsumohet i fresket, ne konserva, sidomos i kripur ne forme fileto. Permbajtja e yndyres arrin nga 6 deri ne 20%. Peshku acuge i konservuar mund te ruhet per shume vite. Ky peshk preferohet shume ne mjaft vende te BE. Peshku i llojit acuge importohet nga vende si Kroacia, Spanja, Italia. Ky produkt i vjen fabrikes se perpunimit te peshkut i trajtuar me kripe gjelle ne bidona plastike. Transporti i tyre behet me kamione frigoriferike te mbyllur hermetikisht, per ta mbrojtur nga faktoret atmosferik dhe te ambientit.

Ne fabrike peshku shkarkohet dhe kontrollohet ne baze te rregullave qe jane caktuar per kete produkt. Shkarkimi behet ne nje ambient shume te paster. Te gjithë bidonave u hedhin uje me kripe. Mbas mbushjes se tyre i vendosin blloqe inerte me peshe 10 kg. Keto blloqe jane te pergatitur per tu perdorur tek bidonat e acuges. Pas kesaj lihen ne kontroll per 5-6 dite.

Per te bere perpunimin e peshkut ai kalohet nga magazinat ruajtese ne repartin pergatites ku ndodhen makina larese e peshkut, i cili me pas shperndahet ne tavolina. Pasi peshku hapet me duar kalohet ne nje vaske me uje te paster dhe te rrjedhshem. Pas shperlarjes se peshkut nga kripa i behet nje trajtim me presion uji ne nje temperature qe vendoset nga teknologu i fabrikes.


Pas ketij procesi peshku kalon me anen e nje transportieri ne nje shperlarje ne uje me kripe. Koncentrimi i ujit me kripe percaktohet nga teknologu ne varesi te kushteve te prodhimit. Me pas ne nje tavoline behet mbeshjtellja e peshkut me rrjeta plastike. Vendoset ne centrifuge ku behet dhe shtrydhja e tij.

Pas shtrydhjes peshku vendoset ne kosha plastike me peshe jo me shume se 2 kg dhe shperndahet ne tavolina ku punetoret e filetimit bejne ndarjen e tij sipas dimensionit. Tavinat ku punojne punetoret jane te veshura me material inoksidabel, ne menyre qe peshku te mos ndikohet nga faktore kimike e biologjike. Punetoret jane te izoluar higjenikisht me produktin. Peshku i pergatitur filet vendoset ne tava plasike konform rregullave te teknologjise se perpunimit te ketij lloji peshku. Fileti qe mblidhet, sistemohet ne kova plastike me peshe 14 kg. Ne secilen kove plastike jane te vendosura etiketat. Ne njerën shenohet numri i llotos si edhe vendi ku eshte prodhuar artikulli, ndersa ne atiketen tjeter shenohet:

- Lloji i peshkut
- Madhesia e peshkut
- Emri i kontrolluesit te cilesise se ketij fileti

Peshku ambalazhohet sipas kerkesave dhe rregullave te percaktuara dhe eksportohet i gjithë produkti sipas destinacionit, kryesisht ne vendet e BE.

Skema e perpunimit te peshkut



1.7 Mbetjet e prodhuara nga aktiviteti perpunues

Veprimtaria e ketij aktiviteti do te shoqerohet me keto lloj mbetjesh:

- Mbetje te ngurta nga procesi teknologjik
- Mbetje te ngurta urbane
- Shkarkime te lengeta qe jane me origjine organike.

- **Mbetjet e ngurta nga procesi teknologjik**

- Skeleti prej kocke,
- Luspa
- Papasterti te tjera.
- Koka peshku

Sasia totale e mbetjeve qe mendohet te gjenerohet eshte 25 ton/muaj

Keto mbetje do te grumbullohen, dhe paketohen e magazinohen ne ambiente frigoriferike – 20°C. Subjekti eshte ne kerkim te vazhdueshem qe te lidhi kontrata me subjekte te licensuara per asgjesimin e tyre ne mometin qe fabrika do te vihet ne pune.

- **Mbetjet e ngurta urbane**

Mbetjet e kartonave dhe plastikave grumbullohen dhe me pas do te dergohen ne vendet e percaktuara nga Njesia Vendore.

Sipas ligjeve shqiptare (Per menaxhimin e integruar te mbetjeve), subjekti qe kryen menaxhimin e ketyre mbetjeve duhet te pasjiet me leje mjedisore dhe me license per plotesimin e kushteve dhe kriterëve per menaxhimin ne menyre te integruar te tyre.

Subjekti gjate aktivitetit te tij nuk gjeneron mbetje te rrezikshme

- **Shkarkime te lengeta qe jane me origjine organike.**

Nga nje regjim pune normal mund te perftohen, ujera te perdorur me perberje uje te zakonshem me NaCl te tretur ne perqendrim te larte, substanca organike qe jane pjese te vogla indore e skeletore, shkarkime te lengeta me perbajtje te larte yndyrne. Cdo dite ne fabriken e perpunimit te peshkut me pune me nje turn mund te shkarkohen rreth 10-12 m³ ujera te ndotura teknologjike te cilat shkojne ne impiantin e trajtimit te ujerave teknologjike dhe me pas kalojne ne nje grope septike e cila do te mirembahet rregullisht.

Per sa i perket ujrave sanitare ato jane vecmas dhe nuk bashkohen me ujerat teknologjike, mirembahen ne nje grope septike tjeter e cila do te pastrohet rregullisht

1.8 Fuqia punetore

Numri i personave qe do te punesohen ne kete projekt do te jene 100 nga zonat perreth. Funkcionet do te jene administrate, mirembajtje, punetore, prodhimi, roje etj. Punonjesit do te punojne 8 ore ne dite dhe 6 dite ne jave. Stafit do ti nenshtrohet trajnimeve per ceshtjet medisore dhe kontrolleve periodike shendetesore.

1.9 Energji, uji, karburant, gaz.

Uji do sigurohet ne rrjet nga ujesjellesi kurse energjia elektrike sigurohet nga rrjeti OSHEE

- Po do kete edhe gjenerator me fuqi 40 kw me nafte

- Po do te instalojme kaldaje e cila do punoj me gaz

Per sa i perket gjeneratorit parashikohet te instalohet nje gjenerator me kapacitet prej 40 kW dhe parashikohet te punojne 50-100 ore/vit, sasia e dieselit te konsumuar per nje vit parashikohet te jete 400-600 litra. Gjithashtu do te instalohet nje kaldaje qe do te per doret per ngrohjen e ujit gjate procesit teknologjik e cila do te punoje me gaz.

1.10 Skema e tokezimeve dhe e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.

Subjekti do te kete nje sistem tokezimi te realizuar sipas nje projekti tip, per te mbrojtur makinerite te cilat punojne me energji elektrike nga ndonje shkarkim atmosferik dhe punonjesit e firmes. Gjithashtu subjekti ka marre masa per termoizolimin dhe mirembajtjen e godines.

Megjithate sygjerojme qe subjekti te marre masa per te verifikuar per funksionim nje here ne vit te gjithe sistemin e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike pasi eshte me mjaft rendesi.

1.11 Masat kunder zjarrit

Me qellim per te siguruar nje nderhyrje te shpejte ne rast zjarri, subjekti do te marre masa per te vendosur nje sistem te perbere nga fikese me shkume. Subjekti njekohesisht ka realizuar dhe takime me stafin per te perballuar situata emergjente.

2 PERSHKRIMI I MJEDISIT

2.1 Popullsia

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti eshte nje zone relativisht e banuar. Ajo i perket Bashkise se Kamzes, ne rrethin e Tiranës. Bashkia e Kamzes është njëri nga 36-të rrethet e Shqipërisë. Rrethi bën pjesë në Qarkun të Tiranës. Bashkia e Kamzes ka rreth 90.000 banorë (sipas Wikipedia), një sipërfaqe prej 21.73 km². Vetëm 7 kilometra larg nga kryeqyteti, sa e re dhe bashkohore aq dhe e rëndësishme për vetë pozicionin strategjik pranë Kryeqytetit Tirane, Aeroportit të Rinasit dhe Portit të Durrësit. Një ndër qytetet më të reja të Shqipërisë, Bashkia Kamëz e dyta më e madhe në Qarkun e Tiranës, dhe e gjashta në Shqipëri. Bashkia e Kamëz kufizohet me Komunes Nikel ne veri, me Njesine Bashkiake Nr 11 ne jug, Komunen Paskuqan ne juglindje, Lumi i Terkuzen ne lindje dhe Lumi i Tiranen ne perendim dhe ne veriperendim me Aeroportin Nderkombetar te Tiranës.

Temperatura mesatare vjetore llogaritet ne 16 °C, sasia mesatare e reshjeve 1297 mm, lartësia mesatare mbi nivelin e detit 57 m.

Tabela 1: Popullsia ne Bashkise Kamez .

Viti 2016		
Rrethi	Popullsi	Sipërfaqja
Kamza	90.000 banorë	21.73 km ² .

2.1.1 Perdorimi i tokes

Tokat bujqësore në rajonin e zones ne studim, kanë pësuar transformime të konsiderueshme në harkun kohor të njëzet viteve të fundit, si pasoje e aktivitetit njerëzor të pakontrolluar. Dëmtimi i zinxhirit të prodhimit bujqësor në rajon ka prekur të gjithë elementët përbërës së tij duke ndërvepruar direkt mbi mjedisin në tërësi si dhe mbi jetën njerëzore.

Politikat territoriale te deritanishme nuk munden te ruanin nje zhvillim te qendrueshem ne Sistemin e Urbanizimit Urbano-Rural si pasoje e kerkeses per zhvillim ne hapsira sherbimi dhe banimi, formale dhe informale. Sistemi i vaditjes se tokave bujqesore dhe sistemi i rezervuareve te rajonit si dhe nderlidhja e tyre me rrjetin e burimeve ujore jane demtuar rende nga mungesa e mirembajtjes si dhe nga demtimet njerezore. Sistemi i magazinimit perpunimit dhe nderlidhjes se tregjeve rajonale eshte inekzistent si pasoj e zhvillimit te pakontrolluar dhe ndryshimit te destinacionit te perdorimit te godinave pas privatizimit te tyre ne vitet 1990. Siperfaqet e tokave bujqesore ne rajon u demtuar rende nga ndertimet formale dhe informale, duke ndryshuar eficencen e tyre ne shfrytezim dhe perdorim si dhe duke ndryshuar statusin e perdorimit te tokes.

2.1.2 Punesimi dhe niveli i jeteses

Sipas te dhenave statistike te marra nga studimi “Living Standards Measurements Survey in 2002 (LSMS)”, niveli me i ulet i jeteses haste ne zonat rurale, familjet e te papuneve dhe familjet me shume femije. Puna ne zonat fshatare paguhet shume me pak se sa ne sektoret e tjere te ekonomise. Sipas nje studimi te kryer ne vitin 2002 te ardhurat nga puna ne bujqesi ishin 2.4 here me te ulta se sa nga puna ne sektoret e tjere te ekonomise dhe 1.7 here me te ulta se sa te ardhurat ne sektoret e

vetepunesimit jashte spheres se bujqesise. Papunesia rrjedh edhe nga niveli i ulet arsimor e social kulturor dhe anasjelltas. Braktisja e shkolles sot nga femijet dot e prodhoje te papune dhe/ose punetore te nenpaguar ne brezat e ardhshem. Hapja e ketij aktiviteti te ri ne zone do te krijoje vende pune me rreth 26 vende te reja pune, pjesa dermuese e te cileve do te merren nga zona perreth.

2.2 Mjedis biologjik dhe fizik

2.2.1 Flora dhe Fauna

Ne zonen e shfrytezimit nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me status te veçante. Zona eshte e mbuluar ne pergjithesi me barishte dhe shkurre mesdhetare dhe shume pak nga bimesi e larte.

2.2.2 Flora

Lista e llojeve te rrezikuara te bimeve ne nivel kombetar eshte shume e madhe, gjithsej 319 lloje, nga te cilat jane te rrezikuara ne forme kritike 76 lloje, konsiderohen ne rrezik 123 lloje dhe te perkeqesuara 120 lloje, te cilat perballen me nje rrezik te larte ne konteksin kombetar. Kercenimet kryesore ndaj biodiversitetit jane: zhvillimi industrial, urbanizimi, gjuetia ilegale, peshkimi, erozioni i tokes, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, sektore keto qe kane ndikim ne shumellojshmerine biologjike. Aktivitetet antropogjene ku shpyllezimi dhe shkretetirezimi i tokes se punueshme, aq sa shkaterrimi i livadheve dhe kullotave, kane pasur nje ndikim te madh ne ndryshimet e habitateve ne te kaluaren e afert. Ndertimi i rugeve dhe ndryshimet ne rrjedhen e ujtit ose ndertimi i digave, ndertimi i tubacioneve, ndotja qe vjen nga origjina te ndryshme, zjarret, semundjet dhe ndryshimet klimatike jane arsyt e degradimit dhe fragmentimit te habitateve ne Shqiperi. Mbrojtja e biodiversitetit mund te arrihet vetem duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes se zhvillimit te qendrueshem ne sektore qe lidhen me biodiversitetin, te tilla si bujqesia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi. Shqiperia njihet per nje diversitet te larte te ekosistemeve. Brenda territorit te saj ka ekosisteme detare, bregdetare, liqenore, lumore, shkurre me gjelberim te perhershem dhe gjethegjere, pyje gjethegjere, pyjet me pisha, kullotat dhe livadhet alpine dhe sub-alpine, dhe ekosistemet e larta malore.

Flora e Shqiperise perfshin rreth 3250 lloje bimore, ose rreth 30% te flores Europiane (Paparisto et al. 1988). Jane 30 lloje endemike dhe rreth 180 lloje subendemike (Vangjeli et al. 1995). Eshte e rendesishme te theksohet se rreth 10% e flores shqiptare, perbehet nga speciet e rralla, speciet e rrezikuara dhe llojet relikte (Vangjeli et al. 1995). Shqiperia eshte e pasur ne burime pyjeve dhe kullotave. Pyjet mbulojne 1,040,881 ha ose 36% te territorit te vendit, dhe kullotat rreth 400,000 ha ose 15%. Perafersisht 60% (244,000 ha) e kullotave jane kullotat alpine dhe sub-alpine dhe livadhe. Pyjet dhe kullotat kane nje larmi te llojeve, formacioneve dhe komuniteteve bimore dhe shtazore. Bimet medicinale dhe aromatike (BMA) ne Shqiperi, kane kushte shume te mira fito-geografike per rritje dhe zhvillim ne natyre. Ato kane nje potencial te rendesishem per zhvillimin social-ekonomik, veçanerisht ne rajonet rurale. Bazuar ne te dhenat e Inventarit Kombetar te

Bimeve Mjekesore dhe Aromatike te kryer ne vitin 1988, fondi i bimeve mjekesore shtrihet ne nje siperfaqe te pergjithshme prej 1183379 ha ose 41.2% te gjithe territorit te vendit. Sipas Fondit

Boteror per Natyren dhe Hartes Ekologjike Digitale te Evropes per Rajonevet nga Agjencia Evropiane e Mjedisit, territori i Shqiperise, mund te ndahet ne tri rajone ekologjike: Pyjet ilire gjetherenes, pyjet e perziera dhe pyjet e perziera Dinariko Alpine. Pyjet, sidomos ato veri veri-lindore, jane shtepi per nje game te gjere te gjitareve, duke perfshire ujkun, ariun, derrin e eger dhe dhine e eger.

Gjate viteve te fundit Shqiperia ka arritur progres dhe ka bere nje investim te madh ne mbrojtjen e ardhshme te pasurive unike natyrore dhe te peizazhit. Ne perputhje me fushat kryesore te punes te identifikuar nga 2000 NBSAP, dhe gjithashtu si rezultat i Programit Kombetar te Punes per Zonat e Mbrojtura (PKPZM) per periudhen 2006-2009, rrjeti i zonave te mbrojtur eshte zgjeruar. Qe nga viti 1996 siperfaqja e shpallur ligjerisht si zone e mbrojtur ne Shqiperi eshte me shume se trefishuar (nga 108,475 ha ne 378,748 ha), duke e çuar perqindjen totale te zonave te mbrojtura nga 5.7 % ne vitin 2002 ne 13.17 % ne vitin 2011.

Rajoni i Tiranës ka nje mbulesë bimore tipike te zones mesdhetare bregdetare.

Speciet mbizoteruese jane si me poshte: *Robinia pseudoacacia*, *Populus tremula*, *Ficus sp.*, *Rubus sp.*, *Celtis australis*, *Platanus orientalis*, *Cornus mas*, *Arundo donax*, *Tamus communis*, *Smilax aspera*, *Ulmus parvifolia*, *Hedera helix*, *Juglans regia*, *Corylus avellan*, *Arundo donax*, *Populus nigra*, *Populus alba*, *Rubus sp.*, *Inula viscosa*, *Salix sp.*, *Typha latifolia*, *Populus nigra*, *Populus alba*, *Salix sp.*

2.2.3 Fauna

Sipas perditeseve me Nentor 2013 te Unionit Nderkombetar per Ruajtjen e Natyres (IUCN), 109 lloje kafshesh te grupeve te ndryshme taksonomike jane konsideruar si te kercenuara, por persa i perket faunes, zona e projektit paraqet specie tipike te zonave rurale.

Rriqebulli, macet e egra, dhe nuselalat jane te rralla, por mbijetojne ne disa pjese te vendit. Ka rreth 760 lloje te kurrizoreve te gjetura deri tani ne Shqiperi. Nder keto ka mbi 350 specie zogjsh, 330 peshq te ujerave te embla dhe detare dhe 80 lloje gjitaresh. Disa prej llojeve me te rendesishme te shpendeve qe gjenden ne vend perfshijne shqiponjen e arte - te njohur si simbol kombetar te Shqiperise - specie te hutave, Capercaillie dhe shpend uji te shumte.

Ekosistemet bregore paraqesin nje biodiversitet me interesant pasi ata paraqesin bimesi bregore natyrore dhe keshtu terheqin faunen qe lidhet me ekosistemet bregore.

Tabela 2. Llojet kryesore te zones ne studim

Nr	Emri shkencor	Statusi kombetar
	Rendi odonata	
1	<i>Sympetrum sanguineum</i>	
	Rendi Orthoptera	
2	<i>Gryllulus frontalis</i>	
3	<i>Calliptamus italicus</i>	
4	<i>Locusta migratoria</i>	
	Rendi Coleoptera	
5	<i>Scarabaeus sacer</i>	
6	<i>Calosoma sycophanta</i>	VU

7	<i>Gyrinus notator</i>	DD
8	<i>Anomala vitis</i>	
9	<i>Oxythorea funesta</i>	
10	<i>Cetonia aurata</i>	
11	<i>Lampyris noctiluca</i>	
12	<i>Coccinella septempunctata</i>	
	Rendi Lepidoptera	
13	<i>Iphiclides podalirius</i>	
14	<i>Papilio machaon</i>	
15	<i>Aporia crataegi</i>	
16	<i>Pieris brassicae</i>	
17	<i>Colias crocea</i>	
18	<i>Gonepteryx Cleopatra</i>	
19	<i>Maniola jurtina</i>	
20	<i>Melanargia galathea</i>	
21	<i>Cynthia cardui</i>	
	Grupi Noturna	
22	<i>Zygaena carniolica</i>	
23	<i>Macroglossum stellatarum</i>	
24	<i>Pelosia muscerda</i>	
	Rendi Neuroptera	
25	<i>Libelloides ottomanus</i>	VU
26	<i>Mantis religiosa</i>	LR (nt)

Herpetofauna (Amfibet dhe Reptilet)

Sic shihet llojshmeria e amfibeve eshte relativisht e ulet edhe per reptile jemi ne te njejten situatë, me pak lloje te pranishme.

Tabela 3. Llojet kryesore te amfibeve te pranishem ne zone

Nr	Emir shkencor	Statusi Kombetar
1.	<i>Bombina variegata</i>	LR (nt)
2.	<i>Bufo bufo</i>	LR (nt)
3.	<i>Bufo viridis</i>	LR (nt)
4.	<i>Rana balcanica</i>	VU



Figure 2. *Bombina variegata*



Figure 3. *Bufo viridis*

Tabela 4. Llojet kryesore te reptileve te pranishem ne zone

Nr	Lloji	Statusi Kombetar
1.	<i>Testudo hermanni</i>	LR (nt)
2.	<i>Anguis fragilis</i>	NE
3.	<i>lacerta trilineala</i>	LR (lc)
4.	<i>Lacerta viridis</i>	LR (lc)
5.	<i>Podarcis muralis</i>	NE
6.	<i>Columber germonensis</i>	LR (nt)



Figure 4. *Podarcis muralis*



Figure 5. *Testudo hermanni*

Nga krahasimi i listes te llojeve te amfibeve e reptileve ne listen e kuqe te Shqiperise rezulton nje numer i madh llojesh qe i perkasin kategorive te llojeve te rrezikuara ne nivel kombetar.

Ornitofauna (Shpendet)

Pjesa me e madhe e shpendeve te hasur ne kete territori jane dimerues dhe shtegtare, lloje qe preken me pak nga shqetesimi apo nderhyrje te tjera humane. Shpendet e perhershem dhe ata folezues te mirefillte jane dhe me te rralle. Ne menyre jot e dretperdrejte ky fakt deshmon pakesim e llojeve te cilet kane nevojte per qetesi te plote. Shpendet e takuar i perkasin mjedisve te tipit te

shkurretave, toka bujqesore te punuara apo te braktisura dhe qendrave te banuara.

Nder ta me te zakonshem jane harabeloret me perfaqesues bilbithat e trishtilat. Ne tokat bujqesore hasen me shpesh laureshat, bishtlekundesat, avdosat etj. Qendrat urbane strehojne shpend te pershtatur ndaj pranise se vazhdueshme te njeriut si dallendyshtet, harabelat, kukuvajkat dhe laraskat.

Tabela 5.Lista e llojeve te shpendeve

Nr .	Lloji	Statusi Kombetar
1.	<i>Accipiter nisus</i>	EN
2.	<i>Buteo buteo</i>	EN
3.	<i>Falco tinnunculuc</i>	EN
4.	<i>Coturnix coturnix</i>	
5.	<i>Streptopelia decaocto</i>	
6.	<i>Apus apus</i>	
7.	<i>Galerida cristata</i>	
8.	<i>Alauda arvensis</i>	
9.	<i>Hirundo rustica</i>	
10.	<i>Hirundo daurica</i>	
11.	<i>Delichon urbica</i>	
12.	<i>Anthus campestris</i>	
13.	<i>Anthus pratensis</i>	
14.	<i>Motocilla cinerea</i>	
15.	<i>Motocilla alba</i>	
16.	<i>Troglodytes troglodytes</i>	
17.	<i>Sylvia atricapilla</i>	
18.	<i>Phylloscopus collybita</i>	
19.	<i>Phoenicurus ochruros</i>	
20.	<i>Saxicola torquata</i>	
21.	<i>Turdus pilaris</i>	
22.	<i>Parus caeruleus</i>	
23.	<i>Parus major</i>	
24.	<i>Lanius collurio</i>	
25.	<i>Pica pica</i>	
26.	<i>Corvus corone cornix</i>	
27.	<i>Sturnus vulgaris</i>	
28.	<i>Passer domesticus</i>	
29.	<i>Passer hispaniolensis</i>	
30.	<i>Passer montanus</i>	
31.	<i>Frigilla coelebs</i>	
32.	<i>Serinus serinus</i>	
33.	<i>Carduelis chloris</i>	
34.	<i>Carduelis carduelis</i>	
35.	<i>Carduelis cannabina</i>	
36.	<i>Miliaria calandra</i>	
		3 lloje

Vetem tre lloje shpendesh jane te rrezikuara ne shkalle kombetare duke treguar keshtu se impakti i

aktivitetit do të ishte përgjithësisht i neglizhuar. Që të tre bëjnë pjesë në rendin e rrembenjesve.

Mammalofauna (Gjitaret)

Nga vrojtimit në terren dhe shqyrtimi i burimeve bibliografike të mundshme mbi gjitaret e zonës është bërë e mundur të hartohet një listë e llojeve të pranishme në zonën e studimit.

Tabela 6. Llojet kryesore të gjitareve të pranishme në zonën e studimit.

Nr.	Lloji	Statusi Kombëtar
1.	<i>Erinaceus concolor</i>	
2.	<i>Talpa caeca</i>	
3.	<i>Crocidura leucodon</i>	
4.	<i>Pipistrellus kuhli</i>	
5.	<i>Pipistrellus pipistrellus</i>	
6.	<i>Mus musculus</i>	
7.	<i>Mus spicilegu</i>	
8.	<i>Rattus norvegicus</i>	
9.	<i>Rattus rattus</i>	
10.	<i>Vulpes vulpes</i>	
11.	<i>Meles meles</i>	
12.	<i>Mustela putorius</i>	EN

Nga krahasimi i listës së mesiperme në listën e kuqe të Shqipërisë dhe anekset e disa konventave ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është pale, rezultojnë se vetëm një lloj i përket kategorive të llojeve të rrezikuara në nivel kombëtar. Kjo njeherazi dëshmon për rëndësinë e paketit të zonës në studim në nivel kombëtar.

2.3 Gjeologjia

Zona në vlerësim ndërtohet nga depozitimet e trajtuara:

- Depozitimet e kuaternarit
- Depozitimet Molasike të Neogjenit

Depozitimet e kuaternarit: Depozitimet detare përfaqësohen nga zhavorre kokërr vogël deri në zhurë, rera, surera, suargjila, argjila dhe shtresa trofike. Janë depozitimet pak deri në mesatarisht të konsoliduara, të cilat në të gjithë zonën ku do të ndërtohet objekti.

Depozitimet e Neogjenit: në këto depozitime të cilat përfshijnë depozitimet e Neogjenit që përbehen nga argjilite dhe alevrolite me ngjyrë gri me cementim të dobët deri në mesatar, pjesa e sipërme e këtyre depozitimeve është e përhapur. Fenomenet më të dukshme gjeologjike dhe gjeodinamike që vërehen në këto zona janë:

Fenomeni i përhapjes, i cili është i dukshëm në formacionet rrenjësore që përbehen nga argjilite dhe alevrolite, këto shkëmbinj janë depozitimet e reja dhe me cementim të dobët argjilor.

2.3.1 Stratigrafia

Rajoni i Tiranës dhe Durrësit ndërtohet nga depozitimet terrigjene të sistemit mio-pliocenik dhe kuaternarit, të cilat sipas përzierjes litologjike klasifikohen në dy grupe të mëdha:

- Formacioni molasik dhe
- Depozitimet kuaternare

2.3.2 Formacioni molasik

I perket moshave Miocen i mesem (N_1^2) – Miocen i siperm (N_1^3) – Pliocen. Litologjikisht ndahen ne njesi te rendeve te ndryshme:

Depozitimet e Miocenit te mesem

Perfaqesohen nga:

- Pakoja e poshteme argjilo – ranore.
- Pakoja e mesme argjilore.
- Pakoja e siperme argjilo-ranore.

Depozitimet e miocenit te siperm

Depozitimet e Tortonianit ($N_1^3 t$)

Perbehen nga nderthurje ranoresh me ato argjilore qe marrin pjese ne ndertimin e structures antiklinale te Peze-shijakut dhe monoklinalit te Prezes. Depozitimet e tortonianit kane trashesi te konsiderueshme nga 1700-3270 m.

Depozitimet e Mesinianit (N_1^3)

Keto depozitime shtrihen normalisht mbi ato te nenshtuara, te Tortonianit. Ne keto depozitime dallohen qarte dylitofacie: litofacia gipsmbajtese dhe litofacia jogipsmbajtese. Ne zonen e ndertimit haste litofacia jogipsmbajtese, e cila perfaqesohet kryesisht nga ranore massive te nderthurur me conglomerate dhe zhavore.

Depozitimet e Pliocenit (N_2)

Depozitimet e Pliocenit te mesem (N_2^2), nga pikepamja litologjikendahen ne dy formacione:

Formacioni Helmesi, me mbizoterim argjilash

Formacioni Rrogozhina, me mbizoterim ranoresh.

2.4 Depozitimet kuaternare

Kane perhapje te gjere, duke mbuluar te gjitha pjesen e ulet te relievit. Ne rajonin e studimit ato shfaqen me te gjitha tippet e tyre gjenetike: depozitime deluviale lagunore – kenetore, aluviale dhe detare. Depozitimet deluviale (Q_4^{dl}), jane te shperndara me teper ne rreze te faqeve te kodrave ne lindje nga subargjila subrera, rera, gravelite dhe zaje me trashesi 2-5m dhe 10-12m. Depozitimet aluviale (Q_4^{al}) dhe lagunore kenetore (Q_4^{kt}) mbushin gjithe rajonin e studimit e me gjere.

2.4.1 Tektonika

Rajoni ne studim ben pjese ne brezin strukturor perendimor te UPM, ku pergjithesisht pranohen marredhenie suksesive te depozitimeve. Karakteristike jane ndertimi i komplikuar tektonik, sedimentet kane trashesi te fuqishme si dhe prania e strukturave antiklinale dhe sinklinale me shtrirje veri-veriperendim, te formuara gjate fazes tektonike pliocen-kuaternar.

Rajoni i Tiranes nga ana tektonike ndahet ne tre elemente strukturale:

Ne sinklinalin e Erzenit te poshtem, me harkun lindor monoklinalin e Pezes, pjesa e veriut antiklinali i Kavajes dhe sinklinali i Durresit. Lugina e Erzenit te poshtem, perfaqeson ne vetevete

pjesen e nje depresioni te thelle e te mbushur me depozitime kuaternare siperfaqesore nen te cilat shtrihen depozitimet Pliocenike. Lugina ka forme ovale. Boshti i saj ka shtrirje veriperendim-juglindje. Nga jugu lugina e Erzenit te poshtem kufizohet nga antiklinali i Kavajes qe eshte nje strukture jo e madhe me bosht veriperendimor. Ne berthame ka depozitime Burdiglianit, ndersa ne krah dhe ne periklinale depozitime te Tortonianit deri ne Pliocen. Gjate sharnierit kjo strukture komplikohet nga nje prishje tektoike, e cila ne pjesen jugore kalon ne kahun perendimor te saj. Krahu lindor i antiklinalit te Durrësit, ne te cilin ben pjese edhe zona e vendosjes se objektit, ndertohet nga argjila te miocenit te siperm, nga pakoja e fuqishme e ndershtrezimeve te argjilave dhe ranoreve te moshes Pliocenike. Sipas te dhenave te puseve kahu lindor I kesaj structure shkeputet tektonikisht.

2.4.2 Neotektonika

Rajoni i Tiranës , sikuresë e gjithë Ultesira prane adriatike eshte kapur nga nje levizje shtypese paspliocenike dhe eshte formuar nga rrudha larterreshqitese, mbihypje dhe kundrahypje, si dhe shtytje. Levizjet shpypese vazhdojen dhe sot.

Ne baze te intensitetit dhe kronologjise se levizjeve vertikale ne Ultesiren anesore Praneadriatike vecohen keto elemente siperfaqesore:

1. Ngritje mesatare te fuqishme nga plioceni.
2. Zhytje mesatare deri te fuqishme ne pliocen dhe ngritje e dobet ne kuaternar.

Rajoni i Tiranës eshte kapur nga zhytja e fuqishme ne pliocen dhe kuaternar.

Struktura e rrudhosur e Ultesires Praneadriatike i nenshtrohet dy fazave shtypese:

1. Njera me e dobet ne kufirin Miocen-Pliocen.
2. Tjetra me e fuqishme ne Pleistocen te poshtem.

Deformimet shtypese vazhdojne deri ne dite tona. Rajoni i Tiranës ndertohet nga disa linja antiklinale relativisht te ngushta (nga studimet gjeofizike te kryera edhe ne det) dhe sinklinale te gjera, lineare Mio-Pliocenike me shtrirje veriperendim deri afer verior. Nga perendimi ne lindje evidentohen keto struktura mio-pliocenike:

-Linja antiklinale Lushnje – Kavaje qe mbyllet ne gjirin e Lalzit.

- Sinklinali i Erzenit te poshtem, i cili vazhdon ne drejtim te veriut, deri ne detin Adriatik.

-Monoklinali i Pezes

-Sinklinali i Tiranës ndiqet pjeserisht ne det deri tek terthorja e Lezhës.

Depozitimet kuaternare detare dhe aluviale, si rregull kane nje trashesi deri 150-200m dhe shtrihen horizontalisht mbi malosen e rrudhosur miocenike-pliocenike.

Nga interpretimet gjeologjike te bera per shkeputje gjatesore te medha dhe rrudhat antiklinale Mio-Pliocenike qe i shoqerojne ato ne Ultesiren Praneadriatike rezulton se mbihypjet dhe kundrahypjet jane ende aktive ne ditet tona, kete e deshmojne termetet e fuqishme te gjeneruara prej tyre.

2.5 Sizmiologji

2.5.1 Tektonika rajonale dhe Sizmiciteti

Shqiperia perfshihet ne brezin orogjenik alpin mesdhetar, i cili eshte rezultat i levizjes se pllakave te medha tektonike (Afrika dhe Euroazia) dhe nje sere pllakash te vogla (pllaka e Adrias). Territori shqipetar kufizohet ne perendim te tij me buzen lindore te mikropllakes se Adrias. Si rezultat i ketyre levizjeve shtytese orogjenike, ne brezat e rrudhosur qe rrethojne mikropllaken e adrias,

gjenerohet nje aktivitet i larte sizmik, i cili prek dhe vendin tone.

2.5.2 Sizmiciteti ne zonen e studimit

Zona ne studim perfshihet ne zonen e burimeve sizmike te Ultesires Praneadriatike, te vleresuar me magnitude maksimale te pritshme te termeteve $M_{max} = 7.0$. Ne kuader te krahines se Tiranës, ku ben pjese, kjo zone i perket njerës prej zonave sizmogjene me potencial sizmik te pritshem nga me te Lartet e territorit te Shqiperise. Vlerat e larta te ketij potenciali i detyrohen faktit se gjeografikisht kjo zone ndodhet prane ballit mbihypes te orogjenit Shqipetar, ne konvergjence me mikroplaken e Adrias. Amplitude e larte e levizjeve shtypese, qe lindin si pasoje e kesaj konvergjence krijon kushte per termite te forta, magnitude e te cileve arrin potencialisht deri ne $M = 7.0$.

Tektonika dhe Sizmiciteti lokal

Edhe shkeputja kunderhypese, qe prek anen lindore te structures se Tiranës, i perket tektonikes pas pliocenike. Kjo shkeputje kalon neper pjesen veriore te antiklinalit te Kryevidhit ne gjirin e Tiranës, ne lindje te antiklinalit te Tiranës dhe ne Bishtin e Palles. Fakti qe thyerja e mesiperme prek edhe depozitimet detare kuaternare, tregon qe ajo eshte active edhe ne ditet e sotme.

Aktiviteti tektonik i zhvilluar pergjate shkeputjeve ne pernedim dhe lindje te qytetit te Tiranës dhe nyjeve te nderprerjes se tyre, qendrojne ne origjinen e aktivitetit sizmik te kesaj zone.

2.5.3 Tokat

Zona ne studim perfaqesohet nga tokat e hinjta. Tokat e Hinjta Kafe jane te perqendruara ne malet e uleta dhe kodrat e zones bregdetare ndermjet lartësive 0 dhe 200 m mbi nivelin e detit (ne disa zona shtrihen deri 600 m lartesi). Duke filluar nga bregu i detit, ato shtrihen ne brendesi te territorit, ne thellesi 80 – 100 km. Formimi i tokave te Hinjta kafe eshte kushtezuar nga klima Mesdhetare kodrinore dhe fushore. Sipas treguesve hidrotermike, ne kete brez tokesor dallohen dy zona klimatike: zona Mesdhetare fushore dhe zona mesdhetare kodrinore.

Materiali primar. Tokat e Hinjta Kafe formohen ne materiale primare me nature te ndryshme, si proluviale, diluviale, aluviale dhe liqenore. Keto te fundit paraqiten me teksture, perberje mineralogjike dhe kimike te ndryshme. Depozitimet proluviale ndeshen mjaft rralle dhe vetem ne fundin e shpateve shume te pjerreta te kodrave. Ato jane te paseleksionuara. Depozitimet deluviale vendosen ne pjesen fundore te shpateve te pjerreta te kodrave. Kane ngjyre te hirte ne te verdhe, perberje mekanike subranore e subargjilore, si dhe permbajne karbonate. Pjesa e trashe e tyre perbehet kryesisht nga kuarci, ndersa pjesa e imet nga hidromikat dhe mineralet e dyta te grupit te montmorilonitit. Pjesa e imet e depozitimeve subargjilore me ngjyre te kuqe perbehet nga hidromikat, caoliniti dhe oksidet e hidratuara te Fe.

Tokat e Hinjta Kafe kane profil te diferencuar ne shkalle te ndryshme. Profili eshte A1-A2-AB-BC-C ose A-AB-B-C ose A-AC-C.




Figure 6. Harta pedologjike e rajonit

2.5.4 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyre

Zona ne fjale nuk ben pjese ne asnje kategori te zonave te mbrojtura dhe nuk mbart vlera kulturore dhe historike per vendi.




Figure 7. Harta e zonave te mbrojtura

(Burimi:Raporti i Gjendjes se Mjedisit 2014)

2.6 Rreshjet

Për shkak të veprimtarisë së gjere ciklonare sasia më e madhe e reshjeve vihen re në gjysmën e ftohtë të vitit, dhe ajo më e ulet në periudhën e ngrohtë të tij. Zona në studim është një nga zonat që karakterizohet nga sasi reshjesh vjetore të ulta mesatarisht 931 mm në vit të cilat bien kryesisht në formë shiu.

Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor (132.9 mm), i ndjekur nga muaji dhjetor (113 mm). Muaji me më pak reshje është muaji korrik me 23.9 mm. Numri i ditëve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 2.4 ditë (korrik) deri në 11.1 ditë (dhjetor). Gjatë vitit ka mesatarisht 86.4 ditë me reshje ≥ 1.0 mm.

Zona në studim nuk klasifikohet si zone me sasi të medha reshjesh 24-oreshe, ose me mire ajo bën pjesë në zonat ku shirat janë me pak të rrembyeshem. Megjithatë nuk përjashtohen edhe rastet kur sasia maksimale 24-oreshe ka arritur 180.8 mm dhe 182.5 mm perkatesisht në muajt nëntor dhe tetor. Ndërsa maksimumi 24 h për periudhën 30 vjeçare varion nga 43.0 mm në korrik (për vlerën me të ulet) deri në 182.5 mm në tetor të vitit 1962.

Rreshjet janë një element i rëndësishëm meteorologjik, që në rajonin e Tiranës kryesisht perfaqësohen nga shiu. Në tabelën me poshtë paraqitet sasia e reshjeve sipas muajve dhe numri i ditëve me rreshje gjatë vitit bazuar në të dhënat shumë vjeçare meteorologjike.

Tabela 7: Sasia e reshjeve mujore dhe numri i ditëve me reshje gjatë vitit bazuar në të dhënat shumë vjeçare meteorologjike

Muajt	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	Vjetor	
Reshjet														
Reshjet mujore mm	112	98	86	60	57	28	12	20	35	131	164	150	983	
Max 24 oresh mm	89	83.6	63	66.1	67	77	35	65.3	72.3	182.5	180.8	59	1042.6	
Numri i ditëve me reshje	0.1 mm	13.3	11.5	10.7	8.8	7.5	4.9	3.5	3.5	5.7	10.7	12.4	14.4	106.9
	5 mm	6.1	5.5	5.1	3.5	3.3	1.8	1.0	1.5	2.5	5.4	8.5	7.2	51.4
	10 mm	4.2	3.3	2.7	1.9	1.9	0.9	0.5	0.9	1.6	3.6	5.5	4.1	31.1

2.7 Temperatura e ajrit

Në rajonin e Tiranës, temperatura e ujit është me e lartë në muajet e verës (Korrik - Gusht), ku edhe sasia e energjisë diellore është me e madhe, ndërsa temperatura me e ulet është në dimër, në muajin Shkurt. Përsa i përket vecorive sezonale mund të pohojmë që gjysma e ngrohtë e vitit prill-shtator karakterizohet nga temperatura mesatare 20.6°C ndërsa gjysma e ftohtë 12.4°C. Ecuria vjetore e temperaturave maksimale absolute të ajrit është e njëjtë me atë të temperaturave mesatare, pra me një minimum në janar dhe maksimum në korrik ose gusht. Temperaturat maksimale absolute $>30^{\circ}\text{C}$ fillojnë të regjistrohen që nga muaji maj dhe vazhdojnë deri në shtator. Temperatura maksimale absolute me e lartë e vrojtuar është 38.6°C në Korrik (viti 1988). Një nga treguesit më të rëndësishëm për të karakterizuar temperaturat maksimale të ajrit është dhe mesatarja maksimale, vlerat e së cilës variojnë nga 12°C në janar deri në 27.8°C në korrik. Në këto zona vrojtohen vlera shumë të ulta të temperaturës minimale absolute. Shfaqja e vlerave negative të këtij treguesi nuk

është ngjarje e rrallë. Keto vlera sigurisht që janë të pranishme në gjysmën e ftohtë të vitit. Minimumi absolut i tyre arrihet në muajin janar (-6.0°C). Por duhet përmendur gjithashtu duke vlera të ulta të ketij treguesi janë vrojtuar qysh në nëntor (-1.6°C) deri në muajin mars (-5.2°C). Kjo zonë, ashtu si edhe në rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga një numër i madh i orëve me diell. Mesatarisht gjatë vitit ka 2655 orë me diell, me vlerën më të lartë në korrik me 355 orë dhe atë më të ulët në dhjetor me 107 orë.

Tabela 8: Temperatura përgjatë vitit në Durrës dhe në Tiranë

Mujore Temperatura	01	02	03	04	05	06	07	08	09	10	11	12	
Mesatare $^{\circ}\text{C}$	7.9	8.8	11.0	14.4	18.1	21.9	24.0	23.9	21.4	17.6	13.7	10.0	
Mesatarja mujore	Me e larta	- 11.6	11. 7	14. 2	16. 6	20. 7	23. 8	26. 2	25. 8	24. 0	20. 2	15. 8	12. 1
	Me e ulta	4.1	5.4	7.8	11. 9	16. 7	19. 4	22. 7	21. 0	19. 6	15. 2	11. 9	6.4
Max.absolute	18.8	22.1	24.9	28.6	31.3	35.0	37.7	39.0	34.0	32.2	26.0	21.7	
Min.absolute	-7.4	-4.6	-3.0	2.4	6.2	11.0	13.6	11.0	8.2	5.0	2.0	-7.2	

2.8 Diellezimi

Rajoni merr sasi të mëdha orësh diell. Vlera e zgjatjes vjetore të djellezimit leviz në kufijte 2600-2700 ore. Edhe numeri i diteve me diell leviz nga 320-330 dite. Vlerat më të larta janë vrojtuar në korrik, 373 ore me diell, dhe më të ultat në dhjetor 118 ore.

Edhe radiacioni diellor ndjek pothuaj të njëjten shpërndarje vjetore si dhe djellezimi. Energjia diellore mesatare gjatë një viti është 1600 kW ore/m^2 , vlerat më të larta janë vrojtuar në korrik 223.5 kW ore/m^2 dhe më të ultat në dhjetor 52.9 kW ore/m^2 , në tabelën e mëposhtme janë dhënë mesataret shumëvjeçare mujore të shpërndarjes së djellezimit si dhe radiacioni diellor i përgjithshëm.

Tabela 9: Diellezimi (ore) dhe radiacioni diellor (kW h/m^2)

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	6.5	5.8	5.2	4.6	5.5	8.1	17. 3	17.6	13. 5	9.6	6. 1	6.1	105.9

Tabela 10: Vlera mesatare e diteve me re

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	12.3	12.6	12. 2	11. 7	7.2	4.3	1.2	1.8	3.6	7.2	11.9	12.7	98.7

Tabela 11: Vlera mesatare e rrezatimit

Stacioni i monitorimit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirana	142. 9	208. 3	30 0	358. 1	476. 8	549. 1	57 0	51 1	398. 7	27 0	172. 5	135. 6	4093

2.9 Era

Ndikimi i Adriatikut eshte i dukshem sidomos per sa i perket shpejtesise se eres dhe rregjimit te saj karakteristik gjate stines se veres. Ererat jane nje element mjaft i rendesishem per gjeografine dhe agrometereologjine e rajonit. Kjo lidhet jo vetem me qarkullimin e pergjithshem t atmosferes por dhe me relieving dhe afersine e detit. Era ka karakterin e puhizes detare vecanerisht gjate sezonit te nxehte, dmth gjate dites era fryn nga deti ne toke, ndersa gjate nates nga toka ne drejtim te kundert. Drejtimi mbizoterues i eres ndryshon sipas stineve. Gjate periudhes se veres era dominuese fryn nga kuadranti i perendimit, nersa gjate periudhes se dimrit era fryn nga kuadranti i lindjes.

Tabela 12: Intesiteti i eres sipas drejtimeve

Nr	Elemente	N° era	Drejtimi							
			V	VL	L	JL	J	JP	P	VP
1.	Shperndarja vjetore drejtimit ne%	11.9	27.5	2.9	4.3	16.7	8.2	4.7	12.5	8.1
2.	Shpejtesia mesatare, m/s	-	3.3	2.4	3.5	4.5	6.7	5.8	4.9	4.4




Figure 8. Trendafili i eres

Sic shihet periudhat pa ere perfaqesojne 11.9% te rasteve te pergjithshme te drejtimit te eres. Duke ju referuar tabelës dhe trendafilit të eres vërejmë që drejtimi verior, N është mbizoteruesi me 27.5%, kurse vlerat minimale të rasteve janë sipas drejtimit verilindor NS me 2.9%. Mesatarja e shpejtesive sipas këtyre drejtimeve respektivisht janë: 3.3 dhe 2.4 m/s.

Tabela 13: Mesatarja e shpejtesise se eres sipas stineve

Nr.	Stinet	Shpejtesia m/s
1	Dimri (XII-I)	4.9
2	Pranvera (III-V)	4.4
3	Vera (VI-VIII)	3.9
4	Vjeshta (IX-XII)	4.3
5	Vjetore (I-XII)	4.4

Duke ju referuar tabelës së mësipërme shpejtësia mesatare në stinën e dimrit është 4.9 m/s, ndërsa mesatarja vjetore 4.4 m/s. Ererat e forta që fryjnë sipas drejtimeve veri, N e juglindje SE me shpejtësi 40-45 m/s kanë në përgjithësi kohezgjatje të kufizuar, kështu që ndikimi i tyre në rregjimin e valesimit është i vogël. Ererat me shpejtësi 10-20 m/s jo vetëm kanë rastisje më të mëdha por kanë dhe drejtim më të qëndrueshëm. Në këto kushte shpejtësia e erës 20 m/s është për zgjedhur si shpejtësi për vlerësimin e valesave maksimale llogaritesë për qëllime projektimi.

2.10 Rrjeti hidrografik i zones në studim

Zona në pikëpamje të infiltrueshmërisë karakterizohet nga grupime shkëmbinjtë dhe dherash: zhavorre proluviale, suargjila deluviale, shkëmbinjtë argjilo-alevrolitiko-ranore të Neogjenit ($N^{3/1}t$) Nga vërtetimet të kryera nga shpimet është konstatuar se niveli i ujerave nentokesor është poshtë 10.0 m përveç në terracën e parë të lumit që rezulton të jetë 4.0-4.5 m nga sipërfaqja e tokës. Brenda kësaj shtrese qarkullojnë ujëra të shumta nentokesor, për vetë faktin se ajo paraqitet pa lidhje kohezionale. Kjo shtrese mbulohet nga suargjila deluviale me filtrueshmëri të ulët. Shtresa e suargjilës që mbulojnë shkëmbinjtë rrenjesor kanë një filtrueshmëri shumë të ulët dhe pikërisht ato që pengojnë ujërat e shiut si dhe sipërfaqësor që të deportojnë në shkëmbinjtë rrenjesor. Shtresa e suargjilës ka një filtrueshmëri shumë të ulët dhe praktikisht nuk lejojnë ujërat nentokesor të qarkullojnë në drejtim të shkëmbinjve rrenjesorë.




Figure 9. Harta hidrogeologjike e rajonit në studim

Parametrat hidraulik te dherave ndryshojne nga nje sektor ne tjetrin per shkak te ndryshimeve te medha ne trashesine dhe menyren e formimit te tyre, por edhe te ndryshimeve te perberjes granulometrike dhe litologjike si ne drejtingjeresor dhe ne ate gjatesor. Ne prodhimet deluviale dhe aluviale pervec ujerave nentokesore te trajtuar me larte ne rajonin e studiuar takohen ujerat e varura me karakter zonal qe formohen ne ndershtresat e rerae brenda suargjilave. Ndersa grupi i shkembinjve te Neogjenit ka nje filtrueshmeri mjaft te ulet. Kjo vjen per vete faktin e ndertimit te tyre nga shtresa argjilo-alevrolitore. Mineralizimi i pergjithshem i tyre luhatet nga 322 mg/l deri ne 500-600 mg/l. Ne lidhje me perberjen kimike, uji eshte i tipit $\text{HCO}_3\text{-Ca-Mg}$. Ne zonen e studimit dallohen disa komplekse ujembajtes sic jane ujembledhesi i Gjokajt (ne distance 728 m nga objekti), perroi i Zejces, perroi i limuthit, ujemledhesi i Berxullit, perroi i Mazrekut te cilet perfundojne ne lumin e Tiranës, i cili me pas derdhet ne lumin e Gjoles dhe si rrjedhim ne lumin e Ishmit si lumi kryesor i zones.

2.11 Cilesia e mjedisit

2.11.1 Cilesia e ujerave siperfaqesore dhe nentokesore

Shqiperia zoteron burime te bollshme te ujit. Edhe pse sasite jane te mjaftueshme per nevojat aktuale, cilesia e tyre shpesh eshte problem per shkak te ndotjes se tanishme dhe historike, sidomos ne zonat e uleta fushore ku jeton pjesa me e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen pjesa me e madhe e aktivitetëve industriale dhe bujqesore. Problem tjetër mbetet shperndarja jo e njetrajtshme e burimeve ujore ne vend. Burimet e pergjithshme, te ripertertishme, te ujit ne Shqiperi perdoren per qellime urbane, industriale dhe bujqesore si edhe per sigurimin e prodhimit te energjise elektrike nga hidrocentralet.

Ujrat siperfaqesore dhe ato nentokesore jane te lidhur dhe varen nga njeri tjetri, por konsiderohen burime te ndara. Shqiperia ka gjashte lumenj te medhenj, ka liqene te medha nderkufitare dhe te lundrueshme, si dhe formacione te rendesishme ujembajtese, megjithate burimet ujore jane te shperndara ne menyre jo te barabarte ne vend. Ne vend ka hidrocentrale dhe rezervuare vaditjeje si dhe nje numer lagunash dhe moçalesh me vlere. Shqiperia renditet midis vendeve qe kane potenciale te medha me uje, baras me 8600 m³ per fryme ne vit.

Derdhja mesatare vjetore e ujit ne det eshte 40,5 bilion m³, e cila korrespondon me nje derdhje prej 1300m³/sek. Reshjet jane nje burim i rendesishem i ujit me nje mesatare aktuale vjetore prej 1485 mm/vit. Burimet e ujerave siperfaqesor perdoren per prodhimin e energjise (hidro-energji), industri dhe vaditje ku formacionet ujembajtese jane shume produktive dhe furnizojne me uje te pijshem shumicen e popullsisë urbane.

Uji perdoret ne te gjitha aspektet e jetes dhe eshte i rendesishem per perdoruesit publik dhe industriale. Si rrjedhoje e sistemeve te papershtatshme te monitorimit, ndryshimet e shpejta ne aktivitetet ekonomike dhe popullsi eshte e veshtire te vleresohet perdorimi i ujit ne terma te sakte.

2.11.2 Cilesia e ajerit ne zone

Cilesia e ajrit ne ne zonen e Projektit kondicionohen, nga dy faktore: ndertimet urbane dhe emetimet nga makinat.

Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve (të ngurta ose të lëngëta) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe kompozime kimike. PM10, PM2.5 i referohet grimcave me diameter 10 dhe 2.5 micrometer ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO2, Nox, NH3 dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogjenike si djegia e lëndës djegëse , ndërtimet, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj. PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojnë sëmundjet e zëmër dhe mushkrive, goditje në zemër dhe aritmi. PM mund të dëmtojë sistemin nervor qëndror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.




Figure 10. Vlerat mesatare vjetore të PM10

Në grafikun nr.8 janë dhënë vlerat mesatare vjetore të PM10 në 3 stacione monitorimi, 2 stacione në Tiranë dhe nga 1 stacion në Durrës. Siç vihet re dhe nga grafiku kemi tejkalim të vlerës kufi të BE prej 40µg/m³ në tre stacione monitorimi në stacionin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë Mjedisit nw Tiranw. Të 2 stacionet jane stacione me burim ndotje trafikun ku numri i makinave që qarkullojnë në rrugët pranë stacioneve është shumë i lartë. Në stacionin e AKM në ndotjen e ajrit nga PM10 përveç shkarkimit të automjeve ndikon edhe pluhuri i rrugëve dhe ndërtimet. Vlera më e lartë ditore është monitoruar në muajin Prill dhe është 142.55 µg/m³ nga 50 µg/m³ që është standarti ditor i BE.

Problematike mbetet numri i ditëve që tejkalon standartin ditor të BE-së (50 µg/m³) në 4 stacione: në stacionin e Tirana AKM numri i ditëve të tejkaluara nga 35 ditë të lejuara është 190%, në stacionin e Tirana MM numri i ditëve të tejkaluara është 77%. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen numri i ditëve që tejkalon standartin ditor të BE-së.

PM10 (ditore)	Numri i diteve te tejkaluar	Numri i diteve te lejuara
Tirana AKM	102	35
Tirane MM	62	35
Durres	ska tejkalim	35

Tabela 14: Numri i ditëve që tejkalon standartin ditor të BE-së. Standarti i BE-së = 50 µg/m³.

2.11.3 Niveli i zhurmave te zones

Udhëzimi i perbashket i Ministrimit te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave dhe Ministri i Shëndetsisn.r.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, percakton vlerat kufi te zhurmave, sipas vlerave udhëzuese të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh). Duhet theksuar se ne afersi te zones se objektit nuk ka qendra te banuara

Tabela nr.16: Nivelet kufi te zhurmes per mjedise te caktuara

Mjedisi	Efkti kritik në shëndet	LA _{eq} (dBA)	Koha bazë (orë)	Lamax Fast (dB)
Zona me aktivitetet social-ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (mjedis i jashtëm dhe i brendshëm)	Dëmtim dëgjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, të jashtme apo të brendshme	Dëmtim dëgjimi	85	1	110
Ceremoni, industri dhe argëtime	Dëmtim dëgjimi (klientët < 5 herë/vit)	100	4	110
Muzikë nëpërmjet kufjeve të dëgjimit	Dëmtim dëgjimi	85# 4	1	110
Tinguj – zhurme impulsive nga fishekzjarret dhe armët e zjarrit	Dëmtim dëgjimi (të rriturit) Dëmtim dëgjimit (fëmijët)	-	-	140#2 120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e mbrojtura	Prishje e qetësisë	#3		

Shpjegime:

Laeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur në shkallën A.

Koha bazë (orë) = Koha gjatë së cilës bëhet matja.

Lamax Fast (dB) = Niveli i matur në shkallën A në mënyrën *fast* (e shpejtë)

1 = Sa më e ulët që të jetë e mundur.

2 = Presioni zanor maksimal (Lamax, fast) matur 100 mm larg veshit.

3= Zonat e jashtme të qeta duhet të mbrohen dhe raporti i zhurmës hyrëse/shtesë me zhurmën e fonit natyral duhet të ruhet sa më i ulët që të jetë e mundur.

4 = Nën kufjet e dëgjimit, përshtatur me vlerat e fushës së lirë.

2.11.4 Menaxhimi i Mbetjeve Urbane

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane përbën një nga problemet më të mprehta në Shqipëri. Politikat në fushën e mbetjeve synojnë përmirësimin e administrimit të mbetjeve, me qëllim që të pakësohen rreziqet që i kanosen shëndetit njerëzor dhe mjedisor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të KE.

Progres më i dukshëm në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane është bërë në drejtim të legjislacionit. Gjatë viteve 2005 – 2012 legjislacioni për menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore/udhëzues që reflektojnë direktivat/vendimet e KE dhe kërkesat e Konventës së Bazelit.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në vitin 2025 e ndarë në 3 faza operacionale me nga 5 vjet secila. Objektivat e kësaj draft strategjie janë:

- Deri në vitin 2015 synon riciklimin/ kompostimin e 25% të mbetjeve bashkiake;
- Deri në vitin 2020 synon të ndalojë rritjen e mbetjeve bashkiake të prodhuara; Riciklimin/kompostimin 55% të mbetjeve bashkiake;
- Deri në 2025: Rikuperimin e energjisë nga 15 % e mbetjeve bashkiake. Reduktimin e mbetjeve bashkiake në lëndfill nga 90% që është aktualisht, në rreth 30%;

Niveli i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri është i ulët. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane ofrohet në shumë qytete, por jo në zonat rurale. Mbetjet depozitohen në vendgrumbullimet e përacktura nga bashkitë. Depozitimi i tyre bëhet sheshet e depozitimit, të cilat nuk plotësojnë parametrat e duhura për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve. Ky menaxhim i dobët i mbetjeve përmes hedhjes së tyre së bashku pa ndonjë ndarje dhe trajtim në vend-depozitim shkakton emëtime të ndotësve në ajër dhe ujë. Në komunitet më të vogla nuk sigurohet shërbimi i mbledhjes së mbetjeve dhe individët janë përgjegjës për largimin e mbetjeve të tyre. Kjo shpesh rezulton në hedhjen pa kriter të mbetjeve përgjatë rrugëve, lumenjve dhe djegien e tyre në mjedis të hapur.

Rikuperimi, ri-përdorimi dhe riciklimi i mbetjeve është mjaft i kufizuar. Sistemi i grumbullimit të mbetjeve për biznesin riciklues është organizuar në mënyrë informale.

Deri tani, megjithëse është pranuar me ligj, mbetjet e rrezikshme hidhen në te njëjtat vende me mbetjet jo të rrezikshme. Paketimi dhe etiketimi i tyre nuk vihet në praktike, megjithëse legjislacioni e parashikon këtë.

3 IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS

3.1 Metodologjia

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të veprimtarise, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh edhe lidhjet e tyre të ndërsjellta. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit. Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrëse për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimi
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e Perbersve të Mjedisit klasifikohet në:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

Ndikimet kryesore ne mjedis nga funksionimi i ketij aktiviteti konsiston ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Ndikim ne pejsazhin e zones
- Emetimet ne ajer (gaze, grimca, aroma)
- Zhurmat dhe vibrimet
- Shkarkimet e lengeta
- Ndikimi ne flore/ faune
- Mbetjet e gjeneruara dhe menaxhimi i tyre
- Ndikime socio-ekonomike
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor

3.2 Vleresimi i ndikimit ne mjedis ne fazen e rikonstruksionit

Ndikimet me te medha ne mjedis per shkak te zbatimit te projektit mendohet te jene:

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	Shpjegim
Pejsazhi	Ndryshim i pejsazhit te zones	Nga zhvillimi i ketij aktiviteti do te dallohet lehtesisht kjo fabrike e perpunimit te peshkut. Vleresohet si permiresim i pejsazhit kur ne fund te fazes se rikonstruksionit si pjesa e brendshme dhe ajo e jashtme e fabrikes do te kete pamje me te rregullt.
Toke	Ngjeshje e tokes	Nuk do te kete asnje ndikim ne strukturen e tokes perreth zones se aktivitetit. Flitet per suvatime dhe rikonstruksione te vogla per te krijuar nje ambient sa me komod dhe te paster per perpunimin e peshkut dhe produkteve te tjera te detit. Aktiviteti do te zhvillohet vetem ne rruge te asfaltuara dhe ne pjesen brendshme te fabrikes.
	Erozion i tokes	Nuk do te kete germime dhe as shpime te tokes. Nuk do te kete asnje ndikim ne erozionin e tokes perreth zones se aktivitetit. Siperfaqja e zones eshte pothuajse e rrafshet dhe e stabilizuar dhe kemi te bejme me ndertim ekzistues.
	Ndotje e tokes	Gjate fazes se rikonstruksionit, do te kemi sjelljen e lendes se pare si cemento, koll etj. Nuk do te kete ndotje te tokes pasi dhe pjesa e llacit dhe te gjitha do te behen me makineri bashkekohore dhe automatike.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesor	Gjate fazes se rikonstruksionit, mund te ndodhe qe te kete shpelarje te lendes se pare nga shirat. Keshillohet qe lendet e para te vendosen ne vende te thata dhe te mbuluara ne menyre qe te mos kete ndotje te ujerave siperfaqesore..
	Ndotje e ujerave	Vleresohet se mund te kete shpelarje te lendes se pare

	nentokesore	dhe mund te kaloje ne ujerat nentokesore.
Ajer	Emisione gazesh	Emisione gazesh gjate aktivitetit do te kemi ne disa veprimtari. <ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi i gjeneratorit. - Mjetet e transportit qe sjellin lenden e pare transportojne produktin perfundimtare, mjetet e marrin mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti, mjetet e punonjesve dhe vizitoreve
	Aromat	Faza e rikonstruksionit nuk shoqerohet me aroma te renda dhe bezdisese, si per punetoret ashtu dhe per banroret e zonave perreth.
	Zhurme, vibrime	Zhurma e vetme do te jete nga levizja e mjeteve gjate transportimit te produkteve. Kjo nuk do te kete nje frekuence te shpeshte. Gjithashtu zhurme mund te shkaktohet edhe nga gjeneratori vetem ne rastet e nderprerjes se energjise.
Mjedisi biologjik	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise. Sic e theksuam dhe me lart, kemi te bejme me nje ndertese ekzistuese dhe nuk ka ndyshim ne floren dhe faunen e kesaj zone.
Mjedisi human	Shqetesim te banoreve te zones	Ne afersi te fabrikes jane disa shtepi informale rreth 100-200m vije ajrore larg zones se fabrikes.
Menaxhimi i mbetjeve	Ndikim ne mjedisin e zones	Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i shoqerise vleresohet te jene mbetje inerte dhe mbetje me si kartona, qese dhe ambalazhe te lendes se pare qe sherben per rikonstruksionin e nderteses. Ato do te mblidhen ne fund te dites se punes dhe do te cohen ne vendet e percaktuara nga Pushteti Vendors
Ndikimet te tjera te projektit	Ndikimet ne trafik	Zona nuk ka fluks te madh trafiku. Aktiviteti mund te ndikojte ne shtimin e trafikut te zones por megjithate ne nivele te pakonsiderueshme.
	Konsumi i energjise	Energjia qe do te perdoret eshte energjia elektrike. Gjeneratori qe funksionon me djegie te naftes do te perdoret vetem ne raste nderprerje energjie.
	Siguria dhe ndikimet ne shendet	Punonjesit para se te punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje librezhe shendetesore e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik. Investitori ka ne stafin e tij dhe nje mjek patolog i cili realizon konsulta periodike.
	Ndikime social-ekonomike	Rritje e punesimit ne nivel lokal dhe rajonal, rritje e te ardhurave te popullsis se zones nga punesimi, rritja e eksporteve te produkteve vendase dhe rritja e nivelit te taksave qe paguan shoqeria.

3.3 Vleresimi i ndikimit ne mjedis ne fazen e funksionimit

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	Shpjegim
Pejsazhi	Ndryshim i pejsazhit te zones	Dallim lehtesisht i dukshem i fabrikes se perpunimit te peshkut te shoqerise Mare Adriatik sh.p.k
Toke	Ngjeshje e tokes	Nuk do te kete asnje ndikim ne strukturen e tokes perreth zones se aktivitetit.
	Erozion i tokes	Nuk do te kete asnje ndikim ne erozionin e tokes perreth zones se aktivitetit. Siperfaqja e zones eshte pothuajse e rrafshet dhe e stabilizuar dhe ndertim ekzistues.
	Ndotje e tokes	Siperfaqet e aktivitetit do te shtrohen me beton dhe do te behet orientimi i ujerat. Mbetjet e aktivitetit do te depozitohen ne kontenitor plastik deri ne momentin e terheqjes nga shoqerite ricikluese perkatese. Nuk kryhen depozitime ne toke te cilat mund te shkaktojne ndotje te tokes dhe ujerave nentokesore. Mundesi te ndotjes nga shkarkime aksidentale te mjeteve te transportit te hidrokarbureve duke krijuar ndotje dhe me pas duke u shplare nga ujerat e shiut.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesor	Ujerat e shiut qe grumbullohen ne sheshet e jashtme te fabrikes derdhen ne kanalet kulluese te zones.
		Ujerat e larjeve do te kalojne ne sistemin e trajtimit dhe me pas orientohen per ne gropen septike te ujerave teknologjike. Subjekti do te mbaje nen kontroll cilesine e ujrave qe shkarkon ne mjediset ujore pritese me ane te monitorimeve periodike.
		Ujerat teknologjik kalojne ne sistemin e trajtimit dhe me pas orientohen per ne gropen septike t e ujerave teknologjike. Subjekti do te mbaje nen kontroll cilesine e ujrave qe shkarkon ne mjediset ujore pritese me ane te monitorimeve periodike.
		Ujerat e ndotura urbane kalojne direkt ne gropa septike te cilat shoqeria do ti mirembaje rregullisht.
	Ndotje e ujerave nentokesore	Ujrat e shirave perbejne nje mundesi potenciale per ndotjen e ujerave nentokesore ne rast kur sheshet jane te ndotura.

Ajer	Emisione gazesh	Emisione gazesh gjate aktivitetit do te kemi ne disa veprimtari. <ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi i gjeneratorit. - Mjetet e transportit qe sjellin lenden e pare transportojne produktin perfundimtare, mjetet e marrin mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti, mjetet e punonjesve dhe vizitoreve.
	Aromat	Ky aktivitet shoqerohet me burim aromash por shoqeria do te marre masa per minimizimin e tyre duke perdorur detergjente cilesore ne pastrim dhe ruajtja e mbetjeve do te behet brenda ambienteve te shoqerise dhe ne kushte frigoriferike. Gjithashtu sugjerohet instalimi i nje sistemi te fuqishem aspirimi.
	Zhurme, vibrime	Nuk do te kete shkaktim zhurme nga aktiviteti i shoqerise. Zhurma e vetme do te jete nga levizja e mjeteve gjate transportimit te produkteve. Kjo nuk do te kete nje frekuence te shpeshte. Gjithashtu zhurme mund te shkaktohet edhe nga gjeneratori vetem ne rastet e nderprerjes se energjise.
Mjedisi biologjik	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise. Subjekti do te realizoje trajtimin e ujrave perpare derdhjes ne mjedisin uxor prites dhe do te realizoje kontrole periodike te cilesise se tyre.
Mjedisi human	Shqetesim te banoreve te zones	Ne afersi te fabrikes jane disa shtepi informale rreth 100-200m larg zones se fabrikes.
Menaxhim i mbetjeve	Ndikim ne mjedisin e zones	Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti i shoqerise jane mbetje me ngarkese te larte bakterologjike te cilat jane : skeleti prej kocke, kokat e peshkuat, luspa, zorret e peshku dhe papasterti te tjera.Subjekti do te lidhe kontrate me subjekte te licensuara per asgjesimin e mbetjeve teknologjike. Mbetjet urbane do te terhiqen nga subjekte qe merren me riciklimin e tyre.
Ndikimet te tjera te projektit	Ndikimet ne trafik	Zona nuk ka fluks te madh trafiku. Aktiviteti mund te ndikojte ne shtimin e trafikut te zones por megjithate ne nivele te pakonsiderueshme.
	Konsumi i energjise	Energjia qe do te perdoret eshte energjia elektrike. Gjeneratori qe funksionon me djegie te naftes do te perdoret vetem ne raste nderprerje energjie.
	Siguria dhe ndikimet ne shendet	Me qellim per te siguruar nje nderhyrje te shpejte ne rast zjarri, subjekti do te marre masa per te vendosur nje sistem te perbere nga fikese me shkume. Subjekti njekohesisht ka realizuar dhe takime me stafin per te perballuar situata emergjente dhe vendosjen e postera

		sensibilizues dhe njoftues . Punonjesit para se te punesohen i nenshtrohen nje vizite mjekesore dhe me pas pajisen me nje libreze shendetesore e cila leshohet nga Drejtoria e Shendetit Publik. Investitori ka ne stafin e tij dhe nje mjek patolog i cili realizon konsulta periodike.Punonjesit e fabrikes do te pajisen dhe me uniforma pune.
	Ndikime social-ekonomike	Rritje e punesimit ne nivel lokal dhe rajonal, rritje e te ardhurave te popullsisë se zones nga punesimi, rritja e eksporteve te produkteve vendase dhe rritja e nivelit te taksave qe paguan shoqeria.

3.4 Mbetjet e ngurta

Mbetjet qe do te gjenerohen nga aktiviteti perpunimit te peshku do te jene rreth 100-150 kg ne dite te cilat jane mbetje organike te tilla si skeleti prej kocke, kokat e peshkuat, luspa, zorret e peshkut lekurat. Keto mbetje do te grumbullohen, paketohen dhe magazinohen ne ambiente te pershtatshme, mbetjet qe gjenerohen nga perpunimi i peshkut do te terhiqen nga kompani te nenkontraktuar dhe te licensuar me te cilat subjekti do te lidhi kontrate.

Mbetjet e kartonave dhe plastikave grumbullohen dhe me pas do te dergohen ne qendra te specializuara te grumbullimit.

Sipas ligjeve shqiptare (Per menaxhimin e integruar te mbetjeve), subjekti qe kryen menaxhimin e ketyre mbetjeve duhet te pasiet me leje mjedisore dhe me license per plotesimin e kushteve dhe kriterëve per menaxhimin ne menyre te integruar te tyre.

3.5 Shkarkimet e lengeta

Shkarkimet e lengeta mund ti kemi vetem ne keto momente:

- Gjate procesit teknologjik te perpunimit te peshkut
- Gjate larjes se ambjenteve te punes

Nga aktiviteti i shoqerise Mare Adriatik sh.p.k do te shpenzohet cdo dite afersisht 30 m³ ujra te perdorura nga larja e nenprodukteve te peshkut dhe produkteve te detit, te cilat pasi mblidhen nepermjet sistemit qarkullues mbledhes te brendeshem do te kalohen ne nje proces filtrimi paraprak duke u cliruar nga mbetjet e ngurta

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti dalin cdo dite ujera te perdorura nga larja e lendes se pare dhe e shesheve te punes. Keto ujera pasi mblidhen nepermjet sistemit te brendshem te kanalizimeve. Ujerat e perdorura kane ne perberje te tyre mbetje organike indore dhe skeletore dhe NaCl te tretur. Keto jane mbetje organike dhe te biodegradueshme.

Ne lidhje me sistemin e trajtimit te ujerave te shoqerise, ajo disponon nje sistem trajtimi te ujerave industriale dhe po punon ne perfeksionimin e tij. Sistemi i trajtimit kalon ne disa faza filtrim fillestar i materialeve te ngurta me ane te nje site metalike, filtrim sekondar me ane te nje

filtri i cili eleminon ne kuoten 95% materialin e patretur, sistem vaskash ne nivel me 3 vaska ku kryhet dekantimi dhe ajerimi per zvogelimin e lendes organike te tretur ne uje dhe ne kete menyre per zvogeluar BOD₅ dhe COD, dekantimi final jashte fabrike perpara shkarkimit ne grupen septike. Vaskat e perpunimit jane ende ne perpunim nga fabrika per perfeksionimin e trajtimit te shenohen dhe ne planin e perputhshmerise. Pasi keto vaska te kene perfunduar do te kryhen edhe analiza ne hyrje dhe ne dalje te sistemit te trajtimit.

Impianti i trajtimit te ujrave teknologjike

Ujerat qe vijne nga perpunimi i peshkut dhe produkteve te tjera te detit jane ujra qe permbajne proteina dhjamore, fosfor, amoniak dhe nje ngarkese mikrobike dhe per kete duhet te trajtohen per heqjen e substancave ndotese. Procesi i pastrimit do te realizohet nepermjet nje impianti trajtimi te ujrave teknologjike. Nepermjet ketij impianti do te behet e mundur pastrimi i ketyre ujrave dhe qellimi eshte qe ne analizat e mostrave te gjitha vlerat e parametrave te dale te jete brenda normave te VKM Nr.177 date 31.3.2005 'Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese'. Nepermjet nje procesi te automatizuar synohet qe te behet nje heqje e te gjithe substancave pezull dhe te precipituara, te yndyrnave, te ererave, te ngjyres, te fosforit dhe te ndotesve te tjere dhe te agjenteve mikrobike dhe shkarkimi i ujrave te kthjellet

Ujerat e perpunimit i nenshtohen fillimisht nje sitosje per heqje te vajra ne vaskat e betonit dhe te ndara ne menyre septike. Pastaj mblidhen ne nje pusete dhe ngrihet ne vaskat e trajtimit per t'iu nenshtuar trajtimit biologjik. Shkarkimi per tu trajtuar, tashme i sitosur dhe i shvajosur, sipas parashikimit, eshte afersisht 40m³/dite. Cikli i trajtimit biologjik behet nepermjet vaskes se paraoksidimit dhe vaskes se oksidimit biologjik. Uji i pastruar ne fund perfundon ne nje serbator te klorifikimit /precipitimit.

Pompes se ngritjes se lengut ne vasken e barazimit i bashkelidhet nje pompe e dozimit te hidroksidit te natriumit ne menyre qe te mbaje ne vaske vlere lehtesisht bazike te pH, per te krijuar keshtu kushte optimale per jeten e flores bakteriale.

Kalimi i ujrave nga nje njesi ne tjetren, behet nepermjet septikeve te pushimit ne menyre qe te mblidhen te tera llumara e fundit te vaskes. Ne vasken e oksidimit futet nga 2 fryres nepermjet nje rrjeti te pabllokueshem, mbas precipitimit behet klorifimi me dozim hipokloriti dhe flokulant te shperndare nga pompa dozuese dhe pastaj shkarkimi brenda normave te ligjeve te Republikes se Shqiperise. Llumrat do te pastrohen periodikisht.

Skema e impiantit te trajtimit te ujrave te ndotura, bashkengjitur ne Aneksin 3

4 MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

4.1 Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Me qellim qe te parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te projektit gjate zhvillimit te aktivitetit te shoqerise Mare Adriatik sh.p.k duhet qe shoqeria te marre masat e nevojshme.

Lloji i masave per mbrojtjen e mjedisit qe do te merren ndahen ne:

1. teknike
2. organizative

Kuadri i masave teknike dhe organizative

Cfare	Si
<p>Parandalim</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Instalimi korrekt i impiantit, me standarte bashkohore europiane, per trajtimi i ujrave qe gjenerohen nga procesi teknologjik - Lidhja e kontratave me subjektet e licensuar me licensat e kategorise III.1.A/B dhe III.2.B nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve ose nga vete subjekti - Siperfaqet e subjektit te jene te betonizuara dhe te pajisura me kanale kulluese. - Kontroll periodik i gjendjes teknike te impianteve dhe mjeteve te transportit - Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per te garantuar nje produkt perfundimtare sipas kerkesave te klienteve dhe me kushte te larta higjieno sanitare -Sigurimi i kontenitoreve qe do te perdoren per mbetjet deri ne kohen kur te transportohen ne kompanite ricikluese. -Pajisja e punonjesve me mjetet e pershtatshme mbrojtese si doreza, maska etj. - Vendorsja e ekstintoreve ne pika te ndryshme te fabrikes dhe trajnimi i stafit per perdorimin e tyre -Vendorsja e tabelave sinjalizuese ne raste emergjente te zjarrit, pikat e grumbullimit etj. - Vendorsja e daljeve te emergjences per kapanonin ku qendrojne punonjesit

Kontroll	<ul style="list-style-type: none"> - Kontroll i vazdueshem i sistemit te trajtimit te ujrave qe gjenerohen nga procesi teknologjik -analizim periodik i shkarkimeve te lengeta nga impianti i trajtimit te ujrave te fabrikes - Kontroll i venddepozitimit te mbeteje te gjeneruara nga procesi teknologjik per rrjedhje - Kontroll viziv periodik te shesheve te punes dhe kontrolli i gjendjen higjieno sanitare te vendeve te punes - Analizim periodik i ujrave te shiut qe grumbullohen ne sheshet e punes.
Nderhyrje	<ul style="list-style-type: none"> - Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike -Mirembajtje te impiantit te trajtimit te ujrave teknologjik dhe nderhyrje ne raste avarish. - Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara nga procesit teknologjik. - Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale - Njofitim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambluanca) - Dezinfektimi i ambjenteve te punes
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike. - Ndarje e pergjegjesise dhe adresim i sakte per ceshtje te sigurise

4.2 Masat zbutese per mbrojtjen e mjedisit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Clirimi i gazeve te demshem per mjedisin gjate perdorimit e gjeneratorit	Perdorimi i impiantit ne oret me energji elektrike nga rrjeti. Kolaudimi i gjeneratorit dhe perdorim i lendeve djegese cilesore.
2	Ndotja e ajerit nga dekompozimi i mbetjeve te peshkut dhe zorreve natyrale dhe perhapja e aromave te tyre ne mjedis	Depozitimi i mbetjeve te gjeneruara nga procesi teknologjik ne ambjente te brendshme te subjektit ne dhoma frigoriferike dhe pastrimi i siperfaqeve ne rast ndotjesh ne menyre aksidentale. Vendosja e sistemit te aspirimit per ambientet e punes. Sistemet e aspirimit te jene te pajisur me filtra per largimin e aromave te pakendeshme perpara shkarkimit te tyre ne mjedisin e zones.
3	Ndotje te ujrave siperfaqesore si pasoje e	Te realizohet trajtimi i ujrave qe gjenerohen nga procesi teknologjik perpara se te shkarkohen ne mjedisin ujor

	derdhjes se ujrave qe gjenerohen nga aktiviteti	<p>prites dhe te realizohen monitorime periodike te cilesise se tyre.</p> <p>Te respektohen normat e percaktuara ne VKM 177 date 31.03.2005 Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese.</p> <p>Ujrat qe grumbullohen ne sheshet e jashtme te punes nga rreshjet te grumbullohen ne sistem kanalizimesh dhe te dergohen ne impiantin e trajtimit ku te trajtohen perpara shkarkimit te tyre ne mjedis.</p>
4	Ndotja e ujrave siperfaqesore te shiut si pasoje e aksidenteve te mundshme	Rekomandohet te behet trajtimi i ketyre ujrave perpara se te shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones.
5	Ndotja e tokes dhe ujrave nentokesore	Duhet realizuar betonimizimi i siperfaqeve te fabrikes dhe depozitimi i mbetjeve te gjeneruara te realizohet brenda subjektit dhe te ruhen ne dhoma frigoriferike. Ne raste aksidentesh te merren te gjitha masat per rikuperimin e ndotjes.
6	Ruajtja/magazinimi i lendeve te ngurta organike sipas standartit dhe kushteve te sigurise.	Perdorimi i dhomave frigoriferike dhe magazinimi ne kushte bashkohore te mbetjeve qe gjenerohen nga procesi teknologjik. Supervizimi i punonjeve qe bejne ngarkimin e ketyre mbetjeve per te evituar derdhjen aksidentale te tyre.
7	Manaxhimi i mbetjeve	Lidhja e kontratave me subjektet e licensuar me licensat e kategorise III.1.A/B dhe III.2.B nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujave, per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve ose nga vete subjekti..
8	Siguria e punonjesve	Subjekti duhet te marre masa per te vendosur nje sistem kunder zjarri ose isktintore ne pika te ndryshme te fabrikes. Subjekti duhet te realizoje dhe simulime me stafin per te perballuar situata emergjente . te vendosen sinjalistika e nevojshme dhe dyert e emergjences dhe te kryhet trajnimi perkates i punonjesve. Punonjesit e fabrikes te pajisen me uniforma pune dhe te gjitha mjetet mbrojtese si doreza dhe maska.
9	Rritja e trafikut te mjeteve te renda ne trafikun tokesor, por ne	Shoqeria duhet te kete ne konsiderate: <ul style="list-style-type: none"> - te perdori infrastruktures ekzistuese, - perdorimi i mjeteve te kolauduara,

	nivele te uleta	<ul style="list-style-type: none"> - qarkullimi ne orare me trafik me pak te renduar, - reduktimi i renies se borieve ne zona te banuara, - organizimi i hyrjes dhe daljes se mjeteve te renda nga fabrika etj.
10	Zhurma nga veprimataria	Procesi teknologjik nuk shoqerohet me nivele te larta te zhurmes. Ne pikat ku niveli i zhurmes eshte me i larte dhe koha e ekspozimit me e gjate te merren masa per punonjesit qe jane te ekspozuar duke perdorur mjete mbrojtese.

4.3 Menaxhimi i mbetjeve te ngurta

Mbetjet organike te aktivitetit duhet te:

- grumbullohen,
- paketohen
- magazinohen ne ambjente frigoriferike
- mbetjet qe gjenerohen nga perpunimi i peshkut do te terhiqen nga kompani te licensuara.

Nga aktiviteti i perpunimit te peshkut do te gjenerohen rreth 80-90 kg ne dite mbetje urbane. Mbetjet e kartonave dhe plastikave grumbullohen dhe me pas do te terhiqen nga subjekte te licensuar .

Sipas ligjeve shqiptare (Per menaxhimin e integruar te mbetjeve), subjekti qe kryen menaxhimin e ketyre mbetjeve duhet te pajiset me leje mjedisore dhe me license per plotesimin e kushteve dhe kriterëve per menaxhimin ne menyre te integruar te tyre.

4.4 Menaxhimi i mbetjeve te lengeta

Shkarkimet e lengeta mund ti kemi vetem ne keto momente:

- Gjate procesit teknologjik te perpunimit te peshkut
- Gjate larjes se ambjenteve te punes

Nga aktiviteti i shoqerise Mare Adriatik sh.p.k do te shpenzohet cdo dite afersisht 30 m³ ujra te perdorura nga larja e nenprodukteve te peshkut dhe produkteve te detit , te cilat pasi mblidhen nepermjet sistemit qarkullues mblidhes te brendshem do te kalohen ne nje proces filtrimi paraprak duke u cliruar nga mbetjet e ngurta. Nga zhvillimi i ketij aktiviteti dalin cdo dite ujera te perdorura nga larja e lendes se pare dhe e shesheve te punes. Keto ujera pasi mblidhen nepermjet sistemit te brendshem te kanalizimeve dhe do te kalojne ne impiantin e ujrave te ndotura teknologjike. Kurse ujerat e shesheve do te kalojne sistemin e kanalizimeve te zones. Ujerat e perdorura kane ne perberje te tyre mbetje organike indore dhe skeletore dhe NaCl te tretur. Keto jane mbetje organike dhe te biodegradueshme. Ne lidhje me shkarkimet e lengeta teknologjike ato do e kalojne nepermjet impiantit te trajtimit ujrave qe do te ngreje kompania. Ujerat qe vijne nga perpunimi i peshkut dhe produkteve te tjera te detit jane ujra qe permbajne proteina dhjamore, fosfor, amoniak dhe nje ngarkese mikrobike dhe per kete duhet

te trajtohen per heqjen e substancave ndotese. Procesi i pastrimit do te realizohet nepermjet nje impianti trajtimi te ujerave teknologjike. Nepermjet ketoj impianti do te behet e mundur pastrimi i ketyre ujerave dhe qellimi eshte qe ne analizat e mostrave te gjitha vlerat e paramtrave te dale te jete brenda normave te VKM nr 177 date 31.3.2005 'Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese'

Nepermjet nje procesi te automatizuar synohet qe te behet nje heqje e te gjitha substancave pezull dhe te precipituara, te yndyrnave, te ererave, te ngjyres, te fosforit dhe te ndotesve te tjere dhe te agjenteve mikrobike dhe shkarkimi i ujerave te kthjellet

Ujerat e perpunimit i nenshtohen fillimisht nje sitosje per heqje te vajra ne vaskat e betonit dhe te ndara ne menyre septike. Pastaj mblidhen ne nje pusete dhe ngrihet ne vaskat e trajtimit per t'iu nenshtruar trajtimit biologjik. Shkarkimi per tu trajtuar, tashme i sitosur dhe i shvajosur, sipas parashikimit eshte afersisht 40m³/dite. Cikli i trajtimit biologjik behet nepermjet vaskes se paraoksidimit dhe vaskes se oksidimit biologjik. Uji i pastruar ne fund perfundon ne nje serbator te klorifikimit /precipitimit.

Pompes se ngritjes se lengut ne vasken e barazimit i bashkelidhet nje pompe e dozimit te hidroksidit te natriumit ne menyre qe te mbaje ne vaske vlera lehtesisht bazike te pH, per te krijuar keshtu kushte apotimale per jeten e flores bakteriale.

Kalimi i ujerave nga nje njesi ne tjetren, behet nepermjet septikeve te pushimit ne menyre qe te mblidhen te tera llumara e fundit te vaskes. Ne vasken e oksidimit futet nga 2 fryres nepermjet nje rrjeti te pabllokueshem, mbas precipitimit behet klorifiimi me dozim hipokloriti dhe flokulant te shperndare nga pompa dozuese dhe pastaj shkarkimi brenda normave te ligjeve te Republikes se Shqiperise. Llumrat do te pastrohen periodikisht dhe do te behet largimi i tyre per ne vendet e caktuara dhe te specializuara per kete gje.

Skema e ketij e Impiantit bashkengjitur ne Aneksin 3.

4.5 Menaxhimi i aromave

Shoqeria duhet te marre masa per minimizimin e aromave. Per kete duhet te:

- perdor detergjente cilesore ne pastrim dhe jo ndotes per mjedisin
- depozitimi e mbetjeve qe gjenerohen nga ky aktivitet do te behet brenda ambjenteve te shoqerise dhe ne kushte frigoriferike
- Subjekti do te monitoroje gjithashtu dhe procesin e ngarkimit dhe transportimit te ketyre mbetjeve per te evituar emetim te aromave edhe gjate transportit

-

4.6 Trajnimi dhe Ndergjegjesimi

Shoqeria duhet te kryej trajnime te stafit ne lidhje me:

- Sigurine ne pune
- Ruajtje te kushteve higjeno sanitare

- Trajnim mbi kushtet dhe problematikat e ndotjes se mjedisit nga aktiviteti
- Veprimet qe duhet te ndermerren ne raste te ndotjes aksidentale
- Perballimi i situatave te zjarrit dhe perdorimi i ekstintoreve
- Trajnim mbi ndihmen e pare

Cdo person shtese i stafit duhet te trajnohet per ceshtjet e mesiperme.


4.7 Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, regjistrohesh dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (DRM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne DRM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

Nr	Natyra e monitorimit	Frekuenca	Analiza
1	Monitorim parametrave fiziko –kimike i ujit te perdorur para shkarkimit (per rastin konkret ujerat qe gjenerohet gjate procesit te perpunimit te peshkut dhe zorreve naturale)	Cdo 3 muaj	<u>Analize e plote.</u> pH, Lenda pezull BOD ₅ COD Yndyrnat Nitrati Total Fosfori Total
2	Monitorimi i menaxhimit te mbetjeve te aktivitetit	Çdo 3 muaj	Kontroll mbi regjistrimin, depozitimi dhe transportimin dhe kontratat me shoqerite ricikluese/ riperdoreuese
3	Monitorimi i zhurmes se shkaktuar	Periodik (raportim cdo 3 muaj)	Zhurma db(A) nga aktiviteti i impiantit ne 4 pika ne rrethim te fabrikes

* Cdo parameter dhe ndikim qe mund te identifikohet nga aktiviteti mund te shtohet si parameter per tu monitoruar

ANEKSI 1- SKEMA E IMPIANTIT TE TRAJTIMIT TE UJRAVE TEKNOLOGJIKE



Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis per aktivitetin e fabrike te perpunimit te peshkut u pergatit nga eksperti mjedisor Elvis Xhaferri te studios per konsulence mjedisore Qendra e Monitorimit te Mjedisit

Eksperti Mjedisor

MSC.Ing. Elvis XHAFERRI

